



**VENDIM**

**Nr. 4 , datë 26.01.2016**

**Mbi "Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2016"**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me dt.26. 01. 2016, analizoi ,diskutoi dhe mori në shqyrtim Relacionin e ardhur nga Bashkia, "Për diskutimin dhe miratimin e projekt buxhetit të Bashkisë për vitin 2016" si dhe Relacionet e tjera të ndryshme bashkëngjitur që analizojnë zërat e shpenzimeve të ndryshme të buxhetit Bashkisë 2016.

Në mbështetje të Kreut VI, nenit 32 gërma "dh" Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar. Mbështetur në Ligjin nr.9936,datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"neni 38,të nenit 19 te ligjit nr.147/2015 "per buxhetin e vitit 2016",në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr 34 dt.28.12.2015 "Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2016", Këshilli Bashkisë

**VENDOSI :**

**Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2016.**

Si më poshtë vijon :

Në ndryshim nga vitet e tjera Buxheti I viti 2016 nuk ka bazë krahasuese, sepse është viti I parë që pasqyrohet nga pikëpamja strukturore dhe Financiare në zbatimin e Ligjit nr. 115/2014"Për ndarjen Administrativo – Teritoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë"  
E parë nga kjo pikëpamje dhe duke qenë se një numur i konsiderueshëm relacionesh shpjeguese janë dhënë nga Sektori i Sherbimeve,për shumë tregues ekonomikë mbi të cilat është mbështetur edhe përgatitja e Buxhetit,mendojmë që për Buxhetin e vitit 2016 të japim disa shpjegime për mënyrën se ai është përgatitur.  
Bazë e shpjegimeve do të jetë vetëm Buxheti i Pakushtëzuar.

**Buxheti i vitit 2016 është i përbërë në dy ndarje kryesore që janë:**

- Buxheti I Pakushtëzuar I Qeverisjes Vendore dhe,
- Buxheti I Pakushtëzuar për Funksionet e reja për vitin 2016.

Pika e dytë e strukturës së Buxhetit sipas shkresës nr.18172 dt.29.12.2015,është edhe e Kushtëzuar pasi e pakushtëzuar është ndarja e Shpenzimeve Operative kurse Fondi I pagave është I Përcaktuar dhe këto ndryshime mund të ketë vetëm pas një kohe të caktuar ku administrata të njihet më mirë me këto funksione dhe ndoshta kur të bëhet edhe njesimi I pagave.

Të analizojmë në fillim pikën e parë:

**Buxheti I Pakushtëzuar I Qeverisjes Vendore përbëhet nga 20 nëndarje përsa I përket shpenzimeve që janë si më poshtë:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKISË



1. 00/1110/01/600 (grupi,titulli,kapitulli,artikulli)"Paga për personelin e aparatit"
2. 00/8140/01/600 "Paga për sportin"
3. 00/8230/01/600 "Paga për Kulturën"
4. 00/1110/01/601 "Sig.Shoq dhe Shëndetës. Për personelin e Aparatit"
5. 00/8140/01/601"Sig. Shoq. Dhe Shënd. Per sportin"
6. 00/8230/01/601"Sig. Shoq. Dhe Shënd. Per Sektorin e Kulturës".
7. 00/1110/01/604 " Trasferta të Brëndëshme" që përfaqëson 1 % e Qarkut(1% e të Ardhurave të Planifikuara)
8. 00/1110/01/606 "Ndihma Ekonomike Nga Nësia Vendore për familjet në nevojë(3% e Buxhetit të përgjithshëm)
9. 00/1110/01/609 "Fond I emrgjencave" (rreth 2% e Buxhetit të Përgjithëshëm)
10. 00/1110/01/602 "Shpenzime Operative për aparatit" ku këtu futen edhe pagat për Këshilltarët dhe Administratorët(kryepleqtë).
11. 00/8140/01/602 "Shpenzime Operative per Sportin"
12. 00/8230/01/602 "Shpenzime Operative për Kulturën"
13. 00/9120/01/602"Shpenzime Operative për Arsimin" që ka qenë funksion edhe I mëparshëm pamvarësisht Funksioneve të reja të Arsimit.
14. 00/6260/01/602 "Shpenzime Operative në Funksion të Pastrimit"
15. 00/6260/01/602 "Shpenzime Operative në Funksion të Gjelbërimit"
16. 00/6260/01/602 "Shpenzime Operative në Funksion të Mirëmbajtjes së Varrezave"
17. 00/6260/01/602 "Shpenzime Operative në Funksion të Dekorit të Qytetit"
18. 00/1110/01/230" Shpenzime Kapitale për Studime e Projekte" që është shumë I rëndësishëm në fazën e planifikimit të fondeve për Investime.
19. 00/1110/01/231 "Shpenzime kapitale për Rritjen e Aktiveve"
20. 00/4530/01/231 "Shpenzime Kapitale nga Fondi I Zhvillimit të Rajoneve" për pjesën e Grantit të trashëguar nga viti I kaluar.

Buxheti i Pakushtëzuar i Funksioneve të reja përbëhet nga zërat e mëposhtëm:

1. 00/9120/01/600 "Pagat e Arsimit Parashkollor Bazë"
2. 00/9120/01/601 "Sig.Shoq. dhe Shëndets. Të Arsimit Parashkollor Bazë"
3. 00/9230/01/600 "Pagat e Arsimit Parauniversitar"
4. 00/9230/01/601 "Sigurimet Shoq. Dhe Shëndetës. Të Arsimit Parauniversitar"
5. 00/4240/01/600 "Pagat e Sekt. Të Ujitjes dhe Kullimit"
6. 00/4240/01/601 "Sigurimet Shoq. Dhe Shëndets. Te Sekt. Të Ujitjes dhe Kullimit"
7. 00/4240/01/602 "Shpenzime Operative të Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, që janë të përcaktuara.
8. 00/4260/01/600 "Pagat e Sektorit të Administrimit të Pyjeve"
9. 00/4260/01/601 " Sigurime Shoq. Dhe Shëndets. Të Administrimit të Pyjeve"
10. 00/4260/01/602 "Shpenzime Operative të Sekt. Të Administrimit të Pyjeve.

Buxheti në tërësinë e vet si kryesore ka Balancimin e tij,pra të Ardhurat të baraspeshohen me shpenzimet.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKISË



Për të Ardhurat e vitit 2016 ,kjo vetëm për Buxhetin e Pakushtëzuar të Qeverisjes Vendore, kemi 4(katër) burime.

Të ardhurat nga Granti I trashëguar nga viti I kaluar në shumën 283 360 lekë që përfaqëson, vlerën e trashëguar nga Fondi I Zhvillimit Të Rajoneve për Projektin “Rruga e Xhamisë, Faza e Parë e projektit total”

Vlera e Trashëguar nga të Ardhurat e Vitit 2015 në shumën 11 956 534.49 lekë që përfaqëson shumat e pa alokuara të të Ardhurave deri ne Nëntor 2015 dhe të Ardhurat e arkëtuara në Dhjetor 2015 që transferohen ne Janar 2016.

Granti I Pakushtëzuar I Qeverisjes Vendore në shumën 99 534 819 lekë, I cili akoma nuk ka një specifikim të saktë në rastin e kufizimeve,por ne kemi respektuar vetëm kufizimin në fondin e pagave, 40% të Grantit është përdorur për Pagat.

Të ardhurat të Planifikuara për vitin 2016 në shumën 164 931 625 lekë,kjo pasqyrohet në planin e të Ardhurave bashkëngjitur Buxhetit.

### Të Ardhurat:

Edhe pse nuk kemi bazë krahasuese mund të bëjmë një analizë të realizimit të të Ardhurave për vitin 2015.

Poshtë kemi një tabelë ku analizohet realizimi I të Ardhurave për muajin dhjetor 2015 dhe për komplet vitin 2015.

Emërtimi	Nr. Llogarise	Dhjetor Fakti 2015	Nentor Plani 2015	realiz. ne %	Shuma depozituar Fakti total	Shuma Totale Plani	realiz. ne %
Takse Biznesi Vogel	7002200	292572.00	1226596.00	23.85	10419398	13511758	77.11
Taks tokes bujqesore	7020100	3891618.00	2545224.00	152.90	20962166	29817848	70.30
Taks Ndertese	7020200	1531063.00	745830.00	205.28	13614634	15086650	90.24
Takse kalim pronesie	7029200	0.00	71200.00	0.00	152552	700000	21.79
rregjistr. Vjetor I automj.	7033001	20000.00	239330.00	8.36	32325	200000	16.16
takse rregj. biznesi	7035001	10000.00	20000.00	50.00	240000	390000	61.54
Taks tregu	7035002	211000.00	176900.00	119.28	4384230	4660000	94.08
jeje ndertimi Kkrrt	7035003	0.00	1000000.00	0.00	5195900	11100000	46.81
Takse fjetje ne hotel	7035005	36000.00	0.00	0.00	2092000	2000000	104.60
Taks reklame	7035008	0.00	73500.00	0.00	523640	814751	64.27
Taks tabele	7035009	25140.00	24880.00	101.05	288974	360760	80.10
takse akti dhe pulle	7081006	50000.00	0.00	0.00	50000	0	0.00
Qera	7109600	0.00	0.00	0.00	0		0.00
tarife akte administrativ	7110105	2300.00	27260.00	8.44	114206	289920	39.39
Leje transporti	7110106	10100.00	265014.00	3.81	694500	3063600	22.67
Taks pastrimi	7110501	402230.00	1991249.00	20.20	5925129	12180263	48.65
Leje banimi	7110504	0.00	0.00	0.00	0		0.00
Tarifa rregullatore	7110599	411880.00	0.00	0.00	8474688	0	0.00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKISË



te Ardh nga kopshtet	7111001	0.00	0.00	0.00	10400	0	0.00
Taks parkimi	7111007	16300.00	19280.00	84.54	151800	260000	58.38
Gjoba	7115499	0.00	0.00	0.00	135000	0	0.00
Taks rregjistrim automjeti	7201101	234123.00	0.00	0.00	3231426	2000000	161.57
te tjera		0.00	1480.00	0.00	7800613	173800	4488.27
					0		0.00
Gjithsej		7144326.00	8427743.00	84.77	84493581.00	96609350.00	87.46

Po të analizojmë me kujdes këtë tabelë ,shohim qartë se realizimi i të ardhurave është realizuar në masën 87.5 % ,që do të thotë se ka një mosrealizim në vlerë absolute prej 12 115 769 lekë.

Pra edhe pse nga pikëpamja e përqindjes së realizimit është e kënaqëshme në vlerë absolute shuma e munguar në Buxhet është e konsideruar.

Ndërsa për të analizuar punën e Sektorit të Tatimeve,në përgjithësi është punuar mirë për vitin 2015 dhe shuma që mungon në Buxhet,për Sektorin e Tatimeve ,vlerësohet deri në 20 Janar 2016, sepse deri në këtë datë Subjektet nuk penalizohen për llogari të vitit 2015.

Ndërsa për disa zëra që janë realizuar në masë shumë të ulët "taksa e kalimit të Pronësisë" 21.8 % , " taksa e rregjistrimit të përvitshëm të automjeteve" 16.2 % , "taksa e lejeve të transportit" 22.7 janë taksa që edhe janë planifikuar gabim por edhe realizimi i tyre nuk varet nga Institucioni jonë por nga Zyra e Rregjistrimit të Pronave dhe Zyra e Rregjistrimit të Automjeteve.

Planifikimi i të Ardhurave për vitin 2016 është në masën 164 931 625

(njëqindgjashtëdhjetëekatërmilion e nëntëqindetridhjetë e njëmijë e gjashtëqind e njëzete e pesë) lekë.

Pra kemi një rritje me 68 322 275 lekë nga viti i kaluar ose një rritje prej 70.7 %.

Në konsultim me Degën e Tatim Taksave kjo shtesë ka rritje kryesore 4 (katër ) zëra më kryesore:

- Taksa e Shfrytëzimit të karburanteve që parashikohet pas ligjit të ri të jetë taksë fikse me 2 000 000 lekë për të gjitha njësitë e tregtimit të karburanteve, që tek ne janë 15 pika shitjesh x 2 000 000 = 30 000 000 lekë.
- Taksa e pastrimi (ndotje mjedisi) për antenat mobile dhe repititivët e tjerë televizivë me rreth 130 000 lekë taksë vjetore tek ne jane rreth 16 të tillë dhe shuma shkon 2 080 000 lekë në vit.
- Taksa e Rentës minerare.Kjo taksë llogaritet si shumë e Rentës Minerare të Kostove vjetore të shfrytëzimit të lëndëve minerare(rërë, zhavorre) që është 5%. Pesëdhjetë % e kësaj shume i takon Pushtetit Vendor nga ana e Drejtorisë së Tatimeve.  
Ne e kemi llogaritur shumën në këtë mënyre:  
për të gjitha njesitë që përpunojnë zhovore lumi dhe toke ne natyre ne kemi llogaritur rreth 150 000 m3 inerte x 1 000 lekë kosto e një m3 =150 000 000 lekë kosto vjetore x5% = 7 500 000 lekë x 50% e kësaj shume = afersisht 3 500 000 lekë.
- Taksa e lejes së përkohëshme e shfytëzimit të brezit të rërës ,që meqenëse do të vilet në vitin e parë ,pra në vitin 2016 ,kemi parashikuar që kjo shumë të shkojë në vlerën 27 500 000 lekë.

Të katër këta tregues rrisin të ardhurat me 60 – 65 milion lekë në vit.

Ndërsa po të flasim për treguesit e tjerë ata janë në nivelin e sotëm dhe me rritjen që do të ketë për efekt të mosrealizimeve të vitit 2015.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKISË



Gjithashtu është bashkëpunuar më Degën e Tatimeve për të gjitha llojet e Taksave dhe tarifave dhe mendojmë se kjo shumë është pothuajse e Arritshme.

Ndërsa për të Ardhurat e Funksioneve të reja, ajo është e përcaktuar ,edhe numri i punonjesve edhe fondi i pagës.

Kurse për Administrimin e Pujeve ,dhe Ujtja e kullimi paga është e përcaktuar edhe numri i punonjësve , dhe ne kemi bërë vetëm ndarjen në 3-mijorë, kjo vlen edhe për shpenzimet Operative.

**Shpenzimet.**

Shpenzimet e realizuara për vitin 2015 janë analizuar në Tabelën e mëposhtëme por sic e thamë ato nuk kanë një bazë të mirëfilltë krahasimi.

Tabela e mëposhtëme tregon realizimin në % për tre vite kjo vetëm për kulturë sepse për dy vitet e para është vetëm për njësinë Qendër dhe për vitin 2015 është edhe për Njësitë Vendore por nga Gushti 2015.

Nr	Emërtimi i artikullit të shpenzimeve	Viti 2013			Viti 2014			Viti 2015		
		Plani	Fakti	Real %	Plani	Fakti	Real %	Plani	Fakti	Real %
	<b>Aparati</b>									
1	Paga (600)	12275	12244	99.75	17208	17208	100	32392	31809	98.20
2	Sig.Shoq (601)	2056	2010	97.76	3023	3023	100	5646	5248	98.20
3	Shp.oper. (602)	5043	5001	99.17	9572	9568	99.96	26006	25654	98.64
4	Projekte (230)	0	0	0	0	0	0	1044	1044	100
5	Investim (231)	1427	1427	100	1585	1302	82.15	5707	5707	100.0
6	Investim nga F.Zhvillimit	13554	11969	88.31	3920	3828	97.65	12391	12107	97.71
9	Investim Min Mjedisit	0	0	0	0	0	0	1879	1879	100.0
8	Nd.ek.inv.(606+604)	43220	43220	100	42462	40954	96.45	92981	81562	87.72
10	Qark (604) + Keshilltaret	2084	2068	99.23	2050	1958	95.51	723	520	72.00
11	Sherbimet Publike	10865	10864	99.99	14761	14677	99.43	21541	21495	99.78
12	KQZ	0	0	0	0	0	0	2099	2092	99.67
	<b>Kultura</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	
1	Paga (600)	1264	1243	98.34	636	631	99.21	774	756	97.67
2	Sig.Shoq (601)	208	193	92.79	153	153	100	108	107	99.00
3	Shp.oper. (602)	15	0		1801	1801	100	1165	1165	100.0
	Sporti	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1	Paga (600)	216	216	100	269	269	100	326	326	100
2	Sig.Shoq (601)	33	33	100	69	66	95.65	49	49	100
3	Shp.oper. (602)	1807	1807	100	4568	4494	98.38	7700	7650	99.35
	<b>Arsimi</b>	1242	1242	100	3132	3132	100	11973	11954	99.84
	<b>Gjendja Civile</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1	Sig.Shoq (601)	793	725	91.42	724	664	91.71	1648	1489	90.35
2	Shp.oper. (602)	132	118	89.39	121	111	91.74	276	248	89.85
3	606- Shpenzime lindje	0	0		395	0	0	2800	2800	100.0
	<b>T O T A L I</b>	96234	94380	98.07	106449	103839	97.55	229228	215661	94.08

Analiza lihet vetë në dorë të Këshilltarëve që ata ta interpretojnë n.q.s do të duan të kenë sqarime për shpenzimet.

Ndërsa për planifikim e shpenzimeve për të gjithë sektorët është bashkëpunura me Sektorin e Shërbimeve dhe janë analizuar në hollësi të gjitha detajet.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKISË



Është punuar me të gjitha Njësitë Administrative për nëvojat që ato kanë për mallra produkte dhe materiale dhe janë parë edhe mundësitë e realizimit nga ana e Bashkisë duke marrë dhe analizuar të gjitha kërkesat.

Më pas janë hartuar preventiva shpenzimesh për të gjitha llojet e produkteve dhe mallrave dhe janë hartuar pasqyra reale mbi bazën e të cilave është paraqitur në Buxhet ,bashkëngjitur këtij Relacioni.

Në hartimin e Buxhetit 2016 janë të sintetizuara disa nga detyrat kryesore Bazë të Funkcionimit të Pushtetit Vendor që është shërbimi ndaj Komunitetit..

Këtë e tregon rritja me 4(kater) herë e shpenzimeve Operative për Arsimin ku kemi planifikuar shuma të konsiderueshme për transportin e nxënësve,për ngrohje dhe për Bursa.

Rritja me disa herë e fondit të ndihmës ekonomike me Vendim të Këshillit Bashkiak për familjet në nevojë.

Gjithashtu rritja e fondit rezervë me disa herë për të mbajtur në gadishmëri forca e mjete në dispozicion të emergjencave.

Këtu vlen të përmendet se Fondi i Pagave për vitin 2016,është në vlerë absolute më i vogël se Fondi i Pagave planifikuar për vitin 2015 gjithashtu edhe fondit për Sigurimet Shoqërore.

I detajuar Buxheti Për vitin 2016 paraqitet si më poshtë:

Buxheti total i të Ardhurave është si më poshtë:

1. të ardhura nga granti i vitit 2015.....	283 360.00 lekë
2. të ardhura të trashëguara nga viti i kaluar.....	11 956 534.49 lekë
3. të ardhura nga Granti i Pakushtëzuar.....	99 534 819.00 lekë
4. të ardhura Planifikuar viti 2016.....	164 931 625.00 lekë

TOTALI

276 706 338.49 lekë

Buxheti total për sa i përket Shpenzimeve është si më poshtë:

1 Fondi i pagave për Aparatin.....	58 150 440.49 lekë
2. Fondi i pagave për Sportin.....	316 000.00 lekë
3. Fondi i pagave për Kulturën.....	676 800 .00 lekë
4 Fondi i Sig.Shoq.Shend Aparatin .....	9 711 132.00 lekë
5 Fondi i Sig.Shoq.Shend Sportin .....	52 780 .00 lekë
6 Fondi i Sig.Shoq.Shend Kulturën .....	113 028.00 lekë
7 Fondi i Qarkut 1%.....	2 198 244.00 lekë
8 Fondi për nd.Ekon. me Vend.Këshilli.....	9 124 500.00 lekë
9 Fondi Rezervë.....	5 632 000.00 lekë
10 Fondi i Shp.Operative Aparati.....	37 103 371.00 lekë
11 Fondi i Shp.Operative Kultura.....	1 886 150.00 lekë
12 Fondi i Shp.Operative Sporti.....	11 217 400.00 lekë
13 Fondi i Shp.Operative Arsimi.....	25 238 225.00 lekë
14 Fondi i Shp.Op.Pastrim .....	35 509 992.00 lekë
15 Fondi i Shp.Op. Gjelberim.....	10 300 008.00 lekë
16 Fondi i Shp.Op.Mirëmbajtje Varreza.....	00 lekë
17 Fondi i Shp.Op. Dekor.....	00 lekë
18 Fondi për studime e projekte.....	26 000 000 .00 lekë
18 Fondi për Investime Paisje.....	40.188 408.00 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKISË



19. Fonde për inv.Nga F.Zhv.Rajoneve.....283 360.00 lekë

TOTALI:.....276 706 388.49 lekë

Nuk kemi bere ndarje buxheti per zerat mirembajtje varreza dhe dekor sepse ne buxhet keto zera perfaqesojne te njejten ze shpenzimi.

Më poshtë po paraqesim edhe Buxhetet për Funkcionet e Reja.

-Granti për Arsimin ParaUniversitar.....1 857 000 lekë

-Shpenzimet:

1. Pagat.....1 591 000 lekë
2. Sigurimet Shoqerore.....266 000 lekë
3. Operative per arsimin Parauniversitar.....643 052 lekë

-Granti për Arsimin Parashkollor.....25 587 000 lekë

-Shpenzimet:

1. Pagat.....21 925 000 lekë
2. Sigurimet Shoqerore.....3 662 000 lekë.
3. Operative per arsimin parashkollor.....7 287 923 lekë

-Granti për Administrimin e Pyjeve.....613 186 lekë

-Shpenzimet:

1. Pagat.....465 651 lekë
2. Sigurimet Shoqerore.....77 767 lekë
3. Shpenzime Operative.....69 768 lekë

-Granti për Ujitjen dhe Kullimin.....2 198 072 lekë

-Shpenzimet:

1. Pagat.....528 000 lekë
2. Sigurimet Shoqerore.....88 105 lekë
3. Shpenzimet Operative.....1 581 967 lekë

- Bashkengjitur ketij Relacioni do te gjeni edhe tabelat si me poshte:
- Tabellen e Buxhetit te Pergjithshem
- Tabellen e Buxhetit për Arsimin për funksionet e Reja
- Tabellen e Buxhetit për Administrimin e Pyjeve dhe Ujtja dhe Kullimi për funksionet e Reja
- Tabellen e Buxhetit për të Ardhurat.....Tab.1
- Tabela e planifikimit te Pagave..... Tab. nr.2
- Tabela e planifikimit të pagave për Arsimin Parauniversitar ..Tab. nr. 3(3/1,3/2)
- Tabela e planifikimi të pagave për Arsimin Parashkollor.....tab.nr.3.2
- Tabela e planifikimit të pagave për Administrimin e Pyjeve.....tab.nr.5
- Tabela e planifikimit të pagave për Ujitjen dhe Kullimin.....tab.nr.5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKISË



- Tabale e analizës së realizimit të të Ardhurave
- Tabela e planifikimit të Investimeve (nga Granti dhe nga të ardhurat)
- Tabela Totale e planifikimit për cdo zë të shpenzimeve Operative për të gjithë Sektorët sipa planifikimit Buxhetor.....tab.nr.7
- Tabelat për cdo zë të shp. Operative (ministri) Sektor.....tabela 7/1 deri 7/7

- Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjithë Drejtoritë dhe zyrat e Bashkisë Rrogozhinë dhe Institucionet në varësi të saj.

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor të Prefektit të Qarkut Tiranë.

Kryetari Këshillit  
Lutfi KASHARI

